

## Haxhi dhe umreja

Thot Allahu xh.sh.:

**“Për hirë të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo, e kush nuk beson (ai nuk e viziton) Allahu nuk është i nevojshëm për (Ibadetin) njerzit”.**

*Transmetohet nga Ebu Hurejra ku thot: Kam dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë: “Kush e kryen haxhin dhe nuk flet fjalë të ndyta e nuk bën vepra të ndyta, kthehet në shtëpinë e tij sikur në ditën kur e ka lindur nëna e tij (pa mëkate)” (Muttefikun alejhi)*

---

Së pari të shpjegojmë shkurtimisht për vizitat në Medine. Dihet se qytet më i rëndësishm pas Mekkes, është Medineja. Në Medine ka momumente të rrëndësishme që duhen vuzituar. Aty është xhamia e Muhamedit a.s. në të cilën gjendet varri i tij a.s. Haxhijtë gjatë vizitës së xhamisë njëkohësisht falin namaze nafile në RAUDA , vizitojnë edhe varrin e Muhamedit a.s. të cilin e përshëndesin me selam.

Përballë xhamisë gjenden varrezat e Medines të quajtura BEKI`AH. Këtu janë afro 10.000 shokë të Muhamedit a.s. të varrosur. Gjatë qëndrimit në Medine bëhen edhe disa vizita tjera të vendeve me peshë të veçantë në historinë Islame.

### Xhamia KUBA:

Me ardhjen e Muhamedit a.s. në Medine, Medinasit e pritën me gëzim të madh. Mu në këtë vend u ngrit edhe xhamia e parë ku u falën besimtarët Zotit të tyre.



## Xhamia KIBLETEJN: (Xhamia e dy kibleve)

Quhet xhamia në të cilën i gjeti ndrimi i kibles muslimanët në namaz. Duke u falur besimtarët erdhi lajmi për ndrimin e Kibles prej Kudsi sherifi kah Mekkeja. Mu për këtë shkak emërtohet kjo xhami me këtë emër.

## UHUD:

Është vendi ku u zhvillua beteja e ashpër midis mushrikëve të Mekkes dhe muslimanëve, pas disfatës që pësuan mushrikët në Bedër. Këtu janë të varrosur 70 shahid në mesin e tyre edhe Hamza r.a. xhaxhait të Muhamedit a.s. Në Medine qëndrohet derisa të falen 40 namaze të cilat vlerën e kanë sa 1000 namaze në xhamiat e botës pos Qabes. Një namaz në Qabe është sa 100.000 namaze. Këta janë vendet kryesore për tu vizituar në Medine.



## **HAXHI TEMETTU`**

### **UMRE**

Haxhijt drejtohen me Autobusët e tyre për në Mekke. Në Mikatin DHUL HULEJFE (vend i cili nuk guxon të kalohet pa veshjen e IHRAMIT), haxhijt veshin ihramin. Para ihramit pastrohen, presin thonjtë, qethen dhe pastrojnë vendet intime (*është mirë që në hotel ti kryejnë këta pastrime*).

Veshin Ihramin dhe bëjnë nijet për umre:

LEBBEJK ALLAHUME UMRE....dhe vazhdojnë duke thënë:  
LEBBEJK ALLAHUME LEBBEJK LEBBEJKE LA SHERIKE LEKE  
LEBBEJK INNEL HAMDE WENNI` METE LEKE WEL MULK LA  
SHERIKE LEK

*(Të përgjigjem o Zot të përgjigjem, Ti je i pa shoq, vetëm Ty të përgjigjem, falemenderimi të takon vetëm Ty. Të gjitha begatitë dhe e tërë pasuri është Ytja. Ti je i pashoq).*

## KUJDES:

Haxhiu nuk duhet harruar se është në ihram. Shumë gjëra që i ka pasur të lejuara, tash i ndalohen. P.sh.

Përdorimi i parfemit, afrimi gruas, mbulimi i fytyrës dhe kokës, veshja e ndonjë rrobe që është e qepur, prerja e thonjëve, flokëve, mustaqeve. Gratë ihram kanë petkun e rrëndomtë të tyre. Krehja e flokëve nuk guxon të bëhet se ndoshta shkakton shkulljen / rënien e tyre.

Kur të arrijmë në Mekke, shkojmë për në Bejtullah (QABE). Hyjmë nga dera të cilën Muhamedi a.s. e ka preferuar (BABUS SELAM) dhe thuam:

“Bismil-lahi Allahume Sal-li ala Muhamed, Allahumeftah lij ebvabe rahmetik”.

Kur e sheh Qaben për herë të parë thuash:

“Allahume entesselamu we minkesselamu fehij-jina rabbena bis-selam”

## TAVAFI:

Tavaf do të thotë të sillesh 7 herë Qabes duke filluar nga HAXHERUL ESWEDI (*Gurri i zi*) dhe deri sa të kthehesh përsëri te ky vend.

Poshtë në mermer është vizatuar një vijë e zezë nga ku mund të hetosh vendnisjen. Para se të fillosh të kesh parasysh çfarë tavafi bën:

Për Umre, për Haxh apo Nafile. E puth dorën e djathtë dhe e drejton kah gurri i zi duke thënë: ALLAHU EKBER (3 herë).

Tre rotullimet e para të tavafit zbulohet krahu dhe shpatulla e djathtë e pastaj mbulohet sërish.

Duke bërë rotullimet rreth Qabes është mirë që sa më shumë të lutesh me zë të ulur ashtu që të mos pengosh kënd. Këta janë: Rabbena atina fiddunja hasaneten we fil ahireti hasaneten wekina adhabennar; Rabbenagfirli we li walidejje we lilimu` minine jeume jekumul hisab.

La ilahe il-lallahu wahdehu la sherikeleh lehul mulku welehul hamdu we huwe ala kul-li shej` in kadir.



Subhanallahu wel hamdulilahi we la ilahe il-lallahu wallahu ekber, we la hauleh we la kuwwete il-la bil-lahil alijjil adhim. Subhanallahu we bihamdihi subhanallahil adhim.  
(Mundet të lutesh çka të duash dhe për kënd të duash).

### **MEKAMI IBRAHIM:**

Pas kryerjes së Tavafit, haxhiu fal dy rekate namaz në drejtim të mekami Ibrahim, duke shiqar në Qabe dhe lexon në rekatin e parë pas Fatihasë (Elhamdulilahir) Kul ja ejjuhul Kafirun dhe në të dytin Ihlas (Kulhuwallah).



### **ZEM ZEM:**

Quhet burimi që doli që në kohë e Ismailit a.s. Haxhiu pi uj nga ky burim i bekuar dhe lutet në formë që dëshiron. Mund të lutesh „O Zot, Ti më mundësove të pij nga uji i Zemzemit, mundësoma të pij edhe nga uji i keutherit“



### **SA`J:**

Kur nëna e Ismailit a.s. Haxherja kërkonte uj për djalin e saj, vrapoi mes dy kodrinave, SAFA dhe MERWA. Edhe haxhijt duhet të ecin mes këtyre dy kodrinave 7 herë. 4 në njëjërën anë dhe 3 në tjetrën. Kur fillojmë kthehemi kah Qabja dhe thuam 3 herë Allahu ekber. Edhe kur arrijmë në Merva thuam Allahu Ekber duke qenë të drejtuar ka Qabja. Kështu veprohet për çdo herë.

## **SHKURTIMI I FLOKËVE**

Tash duhet haxhiu ti shkurtoj flokët dhe pas saj guxon të e çvesh Ihramin.

**KUJDES :**

Nuk guxon të bëhet hjekja e ihramit para shkurtimit të flokëve. Haxhiut i janë lejuar gjërat që iu ndaluan me veshjen e ihramit. Kështu përfunduar me Umren.

Me veshje të rëndomtë qëndrohet disa ditë deri sa të vijë DITA E TERWIJES për të shkuar për në ARAFAT. Në këtë rast vishet ihrami thuajmë nijetin për haxh: LEBBEJK ALLAHUME HAXHXHEN

*(Të përgjigjem o Zot për Haxh. Të lutem që të ma pranosh ate dhe të ma lehtësosh)* pastaj vazhdojmë me TELBIJEN.

Sipas mendimit të Ebu Hanifes në Minna është SUNNET fletja natën e Arafatit, nga i cili vend drejtohen haxhijt për në Arafat në mëngjes.

### **ARAFAT:**

Qëndrimi në Arafat është FARZ. Nëse një haxhi nuk ka qëndruar në Arafat këtë ditë, nuk ka haxh. Këtu falet dreka dhe ikindija në kohën e drekës nga dy rekate farz dhe qëndrohet deri pas perendimit të diellit.



### **MUZDELIFE :**

Me arritje në Muzdelife falet akshami dhe jacija në kohën e jacijës. Falet namazi i sabahut, mbledhen 49 gura-leca (në madhësi të leblebijave apo diçka më më madhe) dhe pas lindjes së diellit nisemi për në Minna.



## **MINNA:**

Sot pra, në ditën e parë të Bajramit gjuhen 7 guraleca në statuen e fundit të shejtanit (në të madhen).

KUJDESE: Këtë ditë gjuhen vetëm 7 e jo të gjitha!!!



## **KURBAN:**

Për haxhijt TEMETTU` sot pritet kurban. Është e mundur që kurban të paguhet dhe e kryen dikush tjetër këtë kusht në emër të tij.

## **QETHJA DHE RRUAJTJA E KRYES:**

Pas gjuajtjes së 7 guralecave të parë haxhiu i shkurton flokët (nëse e rruan kryet është më e lëvdur) dhe guxon ta hjek ihramin.

Dua:

Para çdo gjuajtje thuash:

BISMIL-LAH ALLAHU EKBER

## **TAVAFI ZIJAREH (IFADAH):**

Ky tavaf është FARZ nga farzet e haxhit si IHRAMI ashtu edhe ARFATI. Nëse ka mundësi haxhiu të kryejë tavafin dhe Sa` jin në këtë kohë e kryen e nëse jo më vonë kur të çlodhet.



## **GJUAJTJA E GURALECAVE (2):**

Haxhiu në ditën e dytë gjuan 21 gurë. Fillon nga (ESSUGRA) nga statuja e vogël 7 herë, pastaj në të mesmen 7 herë dhe në të fundit 7 herë.



### **GJUAJTJA E GURALECAVE (3):**

Në ditën e tretë bën të njëjtën sikur në të dytën.

### **TAVAFUL VEDA` AH:**

Ky tavaf i cili quhet Tavafi përshëndetës është riti i fundit që e kryen haxhiu në haxh. Është më mirë që ky tavaf të kryhet pak para nisjes së haxhiut për në vendinlindjen (vendbanimin) e tij.  
LUTJU ALLAHUT TË TA PRANON HAXHIN DHE UMREN TËNDE,  
FAMILJES SATE DHE GJITHË MUSLIMANËVE NË PËRGJITHSI

#### **HAXHI KIRAN**

Në këtë haxh së pari kryhet umreja e pastaj haxhi me një ihram. Pas umres d.m.th. haxhiu nuk hjek ihramin deri ditën pas gjuajtjes me guralecat e parë në ditën e Bajramit. Për haxhin KIRAN pritet kurban dhe veprohet ngjajshëm si me ate temettu` .

#### **HAXHI IFRAD**

Ky haxh nuk ka umre. Haxhiu vesh ihramin për haxh e jo umre dhe bën nijetin për haxh. Pas tavaful kudum (të arritjes) bën sa`jin dhe nuk i qeth flokët. Kështu në ihram qëndron deri në gjuajtjen e guralecëve ditën e Bajramit. Atëherë i qeth flokët apo e rruan kryet dhe lirohet nga ihrami. Për këtë haxh as nuk pritet Kurban e as nuk kryhet umre pas haxhit.